



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister

*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

**Agjencia e Statistikave të Kosovës shpallë: KONKURS TË BRENDËSHËM për këtë vendë të punës:**

**1 . Departamenti i Statistikave Ekonomike , një ( 1 ) pozitë të karrierës:**

**Titulli: Zyrtar për statistika strukturore të bizneseve (ndërmarrjeve)**

**Numri i referencës : ASK-DSE-001**

**Koeficienti : 7**

**Detyrat dhe përgjegjësit :**

1. Bënë përpunimin, analizen dhe përllogaritjen e indikatorëve të statistikave strukturore të ndërmarrjeve (realizimi i planit sipas afatit kalendarik, implementimi i metodologjive të reja sipas planit vjetor të paraparë, përmirësimi i kualitetit përmes aktiviteteve shtesë me përshkrime metodologjike)
2. Mbikëqyrë procesin e punës në të gjitha fazat e zhvillimit dhe ndjek dinamikën në realizimin e afateve të kryerjes së punëve (në marrjen e shënimeve, përpunimin dhe publikimin e tyre),
3. Përgatit indikatorët e statistikave të ndërmarrjeve në harmoni me standardet dhe metodologjitë e Eurostat-it, dhe Organizatave tjera relevante për zhvillimin e statistikave strukturore të ndërmarrjeve
4. Bashkëpunon me sektorët tjerë brenda ASK-së , institucioneve dhe kompanive të ndryshme, me qëllim të sigurimit të të dhënave të nevojshme
5. Kontrollon cilësinë e indikatorëve të statistikave të ndërmarrjeve të përgatitur, propozon ndryshimet e nevojshme për avancimin e kualitetit të të dhënave .
6. Përgatit publikimin e rezultateve finale , si dhe punon rreth projekteve të tjera të parapara në sektorin e statistikave të ndërmarrjeve.
7. Merr pjesë në trajnim edhe vizita të organizuara nga ASK-ja apo nga ndonjë donator tjetër me qëllim të ngritjes së kapacitetit të njohurive lidhur me

përpunimin dhe analizimin e të dhënave në fushën statistikave të ndërmarrjeve,

8. Si dhe kryen punët e tjera që parashihen nga eprori .

**Kualifikimi :** Diploma Universitare – Fakulteti ekonomik apo të ngjashme.

**Përvoja e punës:** Kandidati duhet të ketë 2 vite përvojë pune profesionale

**Kompetenca dhe aftësitë:**

- Njohuri për kalkulimet statistikore ,
- Njohuri profesionale mbi indikatorët ekonomik dhe lëmin e ekonomisë ,
- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës koordinimi eventual i personelit në nivel profesional;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Njohja e gjuhës angleze.

**Procedura e konkurrimit:**

Procedura e konkurrimit është e hapur për nëpunësit civil ekzistues në ASK, të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit për avancim.

Kërkesat për punësim mirën në Zyrën e Arhivës të ASK-së.

Së bashku me formularin për punësim duhet të dorëzohet dëshmia për kualifikim shkollor, dëshmitë për përvojën e punës , vlerësimet e punës si dhe dokumentacione të tjera që lidhen me vendin e punës.

Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

**Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës.**

ASK, ofron mundësi të barabarta të rekrutimit për të gjithë nëpunësit civil ekzistues brenda ASK-së. Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 03/L për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil si dhe Rregullores Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil.

**Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit në Ueb-faqen e ASK dhe në Tabelën e Shpalljeve të ASK.**

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutem të informoheni me Zyrën e personelit në ASK.